



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2026

VENDIM

Nr. 17, datë 19.05.2026

PËR
ANËTARËSIMIN E DEGËS SË BANKËS SË HUAJ
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
“DEGA E BANKËS TÛRKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S.,
ALBANIA” NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 2, pika 1, të nenit 19, nenit 22, pika 5 dhe pika 6, të nenit 23, të nenit 52 pika 1, shkronja “p” dhe të nenit 53, pika 5, shkronja “d” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 22 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7, pika 2 dhe pika 3 të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka”, i ndryshuar, të nenit 7, pika 4 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Anëtarësimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë “Dega e Bankës Türkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania” në skemën e sigurimit të depozitave, si dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave.
2. Autorizohet Kryetari i Këshillit Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm për nënshkrimin e certifikatës për sigurimin e depozitave në degën e bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë “Dega e Bankës Türkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania”.
3. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për njoftimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë “Dega e Bankës Türkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania” për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave dhe për dorëzimin e certifikatës për sigurimin e depozitave, si dhe të informojë Autoritetin Mbikëqyrës mbi këtë vendim.





4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.
5. Ngarkohet Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Kryetar

Shqipe Malaj

Sekretare

